

Arrestohet një person në Novobërdë për armëmbajtje pa leje

LAJME



13/09/2024 23:49



Të premten njësiti i Hetimeve të Stacionit Policor Novobërdë përmes rrugëve operative kanë pranuar informacion se një person në fshatin Bushincë, komuna e Novobërdës është duke ocur nëpër fshat i cili dyshohet se me vete posedon një armë.

Me të pranuar informacionin hetuesit policorë kanë lokalizuar vendndodhjen e të dyshuarit dhe kanë arrestuar të njëjtin.

I dyshuari është 63 vjeçari M.J nga komuniteti serb.

Lajmi është bërë i ditur në një njoftim të fundit të policisë.

Gjatë kontrollit në brez i është gjetur dhe konfiskuar një (1) revole e tipit Cervena Zastava, një (1) karikator dhe tetë fishekë.

Me leje nga Prokurori i Shtetit është realizuar edhe një kontrollë në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të dyshuarit ku janë gjetur dhe konfiskuar edhe dymbëdhjetë (12) fishekë të kalibrit 7.62 mm.

I dyshuari pas shoqërimit në Stacioni Policor në Novobërdë është intervistuar në bazë të procedurave ligjore dhe ndaj tij me urdhër të Prokurorit të Shtetit do të ngritët kallëzim penal për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar të armëve”.

LAJME TË FUNDIT



Sinani flet për vendosjen e shërbimit të detyrueshëm...



Kearns: Vuçiq po e përdor strategjinë e Putin...



Qeveria e Serbisë urdhëron zbatimin e masave për Kosovën



Basha-Haradinajt: Albini veç e ka pastru terenin, Vuçiqi...

Më shumë nga uebi

nativeGRAM

by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



September 14, 2024

Sinani flet për vendosjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në Serbi...



September 14, 2024

Kearns: Vuçiq po e përdor strategjinë e Putin për aneksimin e...



September 14, 2024

Qeveria e Serbisë urdhëron zbatimin e masave për Kosovën



September 14, 2024

Basha-Haradinajt: Albini veç e ka pastru terenin, Vuçiqi po e kërkon...



September 14, 2024

Moska kërcënon me armë bërthamore nëse Ukrainës i lejohe sulmet thellë...



September 14, 2024

Gjuajti me armë zjarri, ndalohet për 48 orë qytetari nga Prizreni

Other Links